



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

KUSHTET DHE TERMET E PËRGJITHSHME TË LICENCËS SË KPM-së PËR DISTRIBUIMIN KABLLOR TË PROGRAMEVE RADIO TELEVIZIVE NË KOSOVË

Përkufizime:

Rregulloret e Komisionit të Pavarur për Media (KPM): Me Rregullore të KPM-së kuptojmë të gjitha qëndrimet për të drejtat dhe detyrat e transmetuesve në Republikën e Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe/ose nga Komisioni i Pavarur për Media që lidhen me transmetuesit dhe distributorët kabllorë të programeve radio televizive në Kosovë.

Dhënia e Licencës: Në pajtim me Nenin 6 të Rregullores për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (tani e tutje Rregullorja CIMC 2007/04) të gjithë operatorët kabllorë të programeve radio televizive në Republikën e Kosovës do të veprojnë në pajtueshmëri me rregullat e KPM-së.

I Licencuari: Do të thotë operatori i sistemit kabllor i cili ofron shërbimet e programit kabllor përmes sistemit kabllor dhe i cili ka përgjegjësi për përmbajtjen e shërbimeve të programit kabllor. I licencuari duhet të jetë person juridik (shoqëri tregtare, ndërmarrje ose operator i pavarur) i regjistruar në pajtueshmëri me ligjet relevante në Kosovë.

Taksa e Licencës: Do të thotë taksa e cila duhet t'i paguhet KPM-së nga i Licencuari, siç është përcaktuar me Nenin 3 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Taksës për Licencim të Operatorëve Kabllorë dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve Përmes Kabllor (tani e tutje Vendimi CIMC 2007/05).

Kohëzgjatja e Licencës: Do të thotë dhjetë (10) vite kohëzgjatje nga data efektive.

Data Efektive: Do të thotë data kur licenca lëshohet nga KPM.

Stacion Televiziv Kabllor: Do të thotë ofruesi i shërbimeve kabllore i cili shpërndan programin e vet nëpërmes sistemit kabllor.

Rrjeti kabllor: Do të thotë rrjet i licencuar telekomunikativ përmes së cilit parapaguesit i ofrohet shërbimi radioteleviziv.

Shërbimi: Do të thotë shpërndarja e programeve radio televizive që i ofrohet parapaguesit nëpërmjet rrjetit televiziv kabllor (shpërndarje kabllore).

Parapaguesi: Do të thotë personi i cili pranon program televiziv kabllor përmes Rrjetit në bazë të një kontrate me të Licencuarin dhe përfshin çdo person që paguan një taksë për pranim të programit.

Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës: do të thotë të drejtat dhe detyrimet e të Licencuarit të përcaktuara nga KPM.

Lista e kanaleve: do të thotë lista e programeve për ri-transmetim apo përbërësit e programit të të licencuarit siç specifikohet në Pjesën 3 të Licencës (“Lista e Kanaleve”).

Program radio dhe televiziv: Do të thotë prezantim audio-vizuel i materialit programor që është i prodhuar në mënyrë ligjore, transmetim apo shpërndarje nga një radio apo TV stacion me logon e tij përmes rrjetit tokësor, kabllor, satelitor apo me pajisje të tjera elektronike dhe e cila si e tillë është e mbrojtur nga e drejta e autorit dhe të drejtat relevante.

1.0 Pajtueshmëria:

1.1 Natyra e Licencës: Pranimi i kësaj Licence përbën një kontratë të detyrueshme për të licencuarin që të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin (tani e tutje Ligji i KPM-së), me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për operatorët kabllorë, me Rregulloren për Shpërndarje të Radio dhe TV Programeve përmes Kabllor në Republikën e Kosovës dhe me të gjitha rregulloret tjera të nxjerra nga KPM.

1.2 Vlefshmëria e Licencës: Vlefshmëria e kësaj Licence është pjesë e pajtueshmërisë me kushtet dhe termet e saj si dhe me dokumentet tjera ligjore të cituara në Nenin 2.1 të Kushteve dhe Termeve të Licencës.

1.3 Përputhja me urdhërat: I Licencuari duhet të veprojë në përputhje me të gjitha urdhërat dhe udhëzimet e ligjshme të dhëna nga KPM për të vënë në

zbatim rregulloret për ri-transmetim të radio apo TV programeve përmes kabllor.

1.4 Qasja në ndërtesa: I Licencuari obligohet të lejojë personelin e KPM-së të hyjë në ndërtesat që i Licencuari i shfrytëzon për ri-transmetim, prodhim programesh ose administratë, me qëllim të inspektimit për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat rregullative të ligjshme të KPM-së.

1.5 Përputhja me Rregulloret e KPM-së: I Licencuari mban përgjegjësi për të vepruar në përputhje me Rregulloren për distribuimin kabllor të programeve radio televizive në Republikën e Kosovës dhe me të gjitha rregulloret e nxjerra nga KPM, për sa i përket të gjitha programeve që ai mund të ri-transmetojë, pavarësisht nga burimi origjinal i një programi të tillë.

1.5.1 I Licencuari që prodhon program të vet radio televiziv do të ketë statusin e Stacionit Televiziv Kabllor kur shpërndan programin e vet përmes rrjetit televiziv kabllor.

1.5.2 I Licencuari që operon si Stacion Televizion Kabllor duhet të rregullohet si subjekt transmetues sipas Ligjit të KPM-së dhe do t'u nënshtrohet të gjitha rregullave dhe rregulloreve të KPM që aplikohen për subjektet transmetuese tokësore.

1.5.3 I Licencuari është i obliguar të shpërndajë programe të shërbimeve transmetuese publike në Kosovë, të përcaktuara në bazë të Nenit 12 të Rregullores CIMC 2007/04.

1.5.4 I Licencuari është i obliguar të bartë programet e subjekteve transmetuese tokësore të licencuara në Republikën e Kosovës përmes rrjetit kabllor, ashtu siç parashihet me Nenin 12.3 të Rregullores CIMC 2007/04.

1.6 Mundësia për përgjigje: Në rast të ndonjë shkeljeje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, ose të rregulloreve në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës, KPM do të sigurojë plotësisht dhe në mënyrë të paanshme mundësinë për t'iu dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve për shkelje.

2.0 Dispozitat për Veprimtarinë

2.1 Detyrimet për të Drejtën e Autorit:

2.1.1 Të licencuarit i kërkohet të veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 2004/45 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale që i bartë në listën e tij programore.

Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që transmetohen nga sateliti.

2.1.2 I licencuari pajtohet që t'i sigurojë KPM-së kopjet e marrëveshjeve për ri-transmetim të programeve para se KPM-ja t'i lëshojë Licencën.

2.1.3 I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës.

2.1.4 Menjëherë pasi të verifikohet nga KPM se operatori kabllor është në shkelje të Licencës duke bartur kanale të programeve pa të drejtën autoriale, KPM do të iniciojë procedurën për revokim të licencës.

2.1.5 Për çdo ndryshim apo modifikim të listës së programeve, skadimin e afatit të kontratës dhe shtimin e kanaleve të reja, KPM duhet të njoftohet 7 ditë para se të bëhen ndryshimet nga i Licencuari. Kopjet valide të marrëveshjeve për të gjitha programet e reja që konsiderohen pjesë përbërëse e listës së programeve për ri-transmetim do t'i dërgohen KPM-së nga ana e operatorit kabllor.

3.0 Informacionet të cilat i Licencuari obligohet t'i ofrojë KPM-së:

3.1 I licencuari duhet që brenda 5 (pesë) ditëve të punës të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme të cilat do të trajtohen nga KPM-ja si çështje të dhënash publike:

- (a) Çdo ndryshim në gjendjen e pronësisë ose pronarëve të kompanive që kanë Licencë të KPM-së ose pronësi të një pjese të saj që mund të çojë në skualifikimin e tyre për marrjen e licencës duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve të punës nga ndryshimi i gjendjes.
- (b) Të dhënat e adresës së operatorit kabllor, telefoni, faksi ose informacione të tjera kontakti;
- (c) Të dhëna mbi menaxhmentin kryesor;
- (d) Identitetin e pronarëve të radhitur në kërkesën për licencë që zotërojnë aksione të një operatori kabllor që është regjistruar si shoqëri aksionare (për çdo ndryshim që kap më shumë se 49% të aksioneve kërkohet miratim paraprak nga KPM-ja në përputhje me paragrafin 4.2 të Kushteve dhe

Termeve e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për operatorët kabllorë);

(e) Identitetin e drejtorëve të kompanisë të cilës i është dhënë licenca.

(f) Ndërprerje të ri-transmetimit më gjatë se programi i planifikuar për një ditë të plotë.

3.2 Identifikimi i Stacionit:

3.2.1 I licencuari që ofron shërbime kabllore duhet të ketë një kanal të veçantë përmes së cilit identifikohet dhe njëkohësisht ofron informacione për parapaguesit për çdo ndryshim të mundshëm rreth shërbimeve të programeve përmes kabllor.

3.2.2 I licencuari duhet që të identifikojë qartë dhe në vazhdimësi burimin e programit të ri-transmetuar.

3.3 Praktikrat e mbrojtjes së shëndetit:

3.3.1 I licencuari duhet t'i vërë në funksionim të gjitha sistemet dhe objektet e transmetimit për sa i përket mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve, dhe të publikut në përgjithësi, në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

3.3.2 Strukturat e pajisjeve teknike duhet të jenë konform standardeve të përgjithshme Evropiane të pranuarra për sigurinë e konstruksionit dhe të mirëmbajtjes në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

3.4 Ndërprerjet e Transmetimit: Operatori kabllor obligohet t'i paralajmërojë parapaguesit për ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të ri-transmetimit përmes kanalit të veçantë, siç definohet me Nenin 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Licencës, dhe ta njoftojë me shkrim KPM për arsyet e ndërprerjeve të tilla.

3.5 Pagesa për Licencën: Për marrjen e licencës, i licencuari duhet të paguajë një pagesë në bazë të Nenit 5 të Vendimit CIMC 2007/05 dhe në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC 2007/04.

4.0 Përdorimi dhe Transferimi i Licencës:

4.1 Karakteri i Licencës: Kjo licencë është një dhënie e kushtëzuar e lejes nga ana e KPM-së për të ofruar shërbime të programeve në radio apo TV përmes kabllor.

4.2 Transferimi ose Dorëzimi i Licencës: I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së. Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 49% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të licencuarit kërkohet paraprakisht miratim me shkrim nga ana e KPM-së.

4.3 Leja për transferimin: KPM do të lejojë transferimin e licencës vetëm pasi të jetë siguruar që kandidati të cilit propozohet që t'i transferohet licenca plotëson standardet e KPM-së për t'u pajisur me licencë të KPM-së. Në bazë të mandatit të saj, KPM mund të kërkojë që çdo transferim i një licence tek një pronësi e re t'i nënshtrohet procedurave të rregullta për të siguruar që një transferim i tillë është në pajtueshmëri me të gjitha rregulloret e KPM-së.

5.0 Sanksionet për mosrespektimin e Licencës dhe Rregulloreve të KPM-së:

5.1 Sanksionet e zbatueshme: Shkelja e Kushteve dhe Termeve të kësaj Licence ose dokumenteve ligjore që e shoqërojnë atë mund të çojë në një ose më shumë nga sanksionet e mëposhtme të specifikuar në Nenin 20 të Ligjit të KPM-së dhe Nenit 19 të Rregullores CIMC 2007/04.

6.0 Pezullimi apo Anulimi i Licencës:

6.1 I licencuari merr njoftim dhe pranon që shkelja e Kushteve dhe Termeve të kësaj Licence dhe mosrespektimi i rregulloreve të nxjerra nga KPM në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, iu nënshtrohet sanksioneve të parapara në Nenin 20.1 të Ligjit të KPM-së dhe Nenit 19 të Rregullores CIMC 2007/04 duke përfshirë edhe anulimin e licencës, nëse këto shkelje konsiderohen shkelje të rënda të kësaj marrëveshjeje për licencën.

7.0 Forca Madhore:

7.1 Marrja në konsideratë e Forcës Madhore: Në vlerësimin e neglizhimit të të licencuarit për të vepruar sipas Kushteve dhe Termeve të Licencës së tij, KPM do të merr parasysh të gjitha rrethanat e rënda dhe të pakontrollueshme nga një *forcë madhore*, siç janë nxjerrja jashtë nga objektet, zjarri, eksplodimi ose trazira sociale.

7.2 Mos-zbatimi i tarifave të licencës: Rrethanat e radhitura në Nenin 8.1 të Kushteve dhe Termeve të Licencës së KPM-së për Operatorët Kabllorë, nuk do të përdoren për të justifikuar pezullimin e pagesave të licencës që duhen paguar. Gjithashtu, prishjet e vogla të pajisjeve që nuk ndikojnë në pengimin e funksionimit të Operatorit Kabllor nuk do të interpretohen si *forcë madhore*.

8.0 Amandamenti i licencës:

- 8.1** Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë, të specifikuar në Nenin 8 të Rregullores së Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshime në licencë duke ia bërë me shkrim KPM-së kërkesën për këto ndryshime. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.
- 8.2** Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e licencës së të Licencuarit, me një procedurë të përcaktuar në përputhje me Ligjin e KPM-së, duke u siguruar që këto ndryshime do të jenë shumë të nevojshme për zbatim më efikas të licencës. I Licencuari, në mënyrë të arsyeshme, do të ketë mundësi që të bëjë paraqitjen para KPM-së, për sa i përket ndryshimeve të propozuara nga ana e KPM-së.

Me anë të nënshkrimit këtu më poshtë, i Licencuari i pranon dhe obligohet t'i respektojë të gjitha Kushtet dhe Termet e përcaktuara të kësaj Licence, përfshirë edhe Rregulloren e KPM-së CIMC 2007/04, Vendimin CIMC 2007/05, të gjitha aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, ligjet dhe rregulloret relevante të aplikueshme në Kosovë.

EMRI:

DATA:

NËNSHKRIMI:

Për të Licensuarin:

Me nënshkrimin e këtij dokumenti, kjo Licencë do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme duke i dhënë të drejtën të Licencuarit për shpërndarjen e programeve radio televizive në rrjetin kabllor.

EMRI:

DATA:

**Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së**

NËNSHKRIMI:

VULA
